



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË UJITJES DHE ADMINISTRIMIT PYJEVE**  
**SEKTORI INSPEKTIMIT MBROJTJES PYJEVE E KULLOTAVE**

**PROJEKT - VENDIM**

Nr 5302, Datë 23. 04 2026

**PËR**  
**MIRATIMIN E PLAN-MASAVE PËR PARANDALIMIN, MENAXHIMIN DHE**  
**SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA SI DHE KRIJIMIN E**  
**NJËSIVE VULLNETARE TË SHUARJES SË ZJARREVE PËR VITIN 2026.**

Bazuar në Ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin nr.57/2020 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 30, pika 4, germa c, ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kollusor” i ndryshuar në ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, ligjin nr. 45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, ligjin nr.152 datë 22.12.2015 , “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”, VKM Nr.1080 datë 22.12.2010, “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota”, pas shqyrtimit të Planit të Masave.

**VENDOSI :**

1. Të miratojë Planin e Masave për parandalimin, menaxhimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota si dhe krijimin e Njesisë Vullnetare të shuarjes së zjarreve për vitin 2026.
2. Për krijimin e Njësive Vullnetare ngarkohen, Njësitë Administrative .
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

**KRYETARI**  
**Pjerin Ndreu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE**  
**SEKTORI INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES PYJEVE E KULLOTAVE**

Nr 5302/ Prot

Datë 23/ 04 2026

**RELACION**

**Drejtuar : Këshilit Bashkiak .**

**Të nderuar Këshilltarë !**

**Baza Ligjore :**

Ligji nr 139 datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" Ligji nr 8480 datë 27.05.1999 ,  
Për funksionimin e organeve kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike  
Ligji 57/ 2020 datë 30.4.2020 " Për Pyjet " neni 30 pika 4 gërma c . Ligji nr 9693 datë  
19.03.2007 " për fondin kollusor " I ndryshuar ligji nr 10434 datë 09.06.2011, " Për  
Mbrojtjen e Mjedisit" ,Ligji nr 45 datë 18.07.2019, " Për Mbrojtjen Civile " Ligji nr 152  
datë 21.12.2015, " Për Shërbimin e Mbrojtjes nga zjarri dhe Shpëtimi " VKM – nr 1080,  
datë 22.12.2010 , " Mbi rregullat për parandalimin e shuarjes së zjarreve në pyje e  
kullota".

Sektori i Inspektimit Mbrojtjes Pyjeve dhe Kullotave pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes  
dhe Administrimit të Pyjeve ka hartuar planin e masave për parandalimin, menaxhimin dhe  
shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe krijimin e njësive vullnetare për shuarjen e  
zjarreve të vitit 2026.

Në këtë plan masash janë vendosur përkufizimet bazë lidhur me përmasat e zjarrit.  
Organizimi i ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit, emergjencat civile, fatkeqësi  
natyrore, mbrojtje civile etj.

Referuar këtyre përkufizimeve të ligjit për pyjet është planifikuar që pranë Bashkisë  
Lezhë të funksionojë "Shtabi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi " i cili do të drejtojë dhe  
organizojë të gjithë veprimtarinë për :

"Organizimin e ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit".

Shtabi kryesohet nga Kryetari i Bashkisë Z. Pjerin Ndreu dhe Zv.Kryetari i Bashkisë Z.  
Fatjon Zefi i cili është në funksionin e Sekretarit të Shtabit dhe pjesë e tij janë  
Administratorët e Njësive Administrative të cilat kanë fond pyjor dhe kullor në  
territorin e tyre si dhe Drejtorët e Drejtorive që lidhen në aspektet e mbrojtjes, shpëtimit  
dhe kujdesit social.

Plani i masave do të zbatohet nga Sektori Inspektimit Mbrojtjes Pyjeve dhe Kullotave e cila do të ndjekë me përparësi të gjitha aktivitetet që lidhen me ndërgjegjësimin e komunitetit, monitorimin e kontrollin e vazhdueshëm të fondit pyjor me qëllim parandalimin e rënies së zjarreve si dhe kordinimin e ndërhyrjes ne rastet e shfaqjes së zjarreve. Si rezultat i zbatimit të Planit të Masave, organizimit e koordinimit të punës me aktorë lokal dhe ndjekjës me përparësi të situates në Bashki.

Duke pritur miratimin tuaj , ju falenderojmë për mirëkuptimin.

Hartoi relacionin :  
Përgjegjësi I Sektorit Inspektimit  
Viktor Ujkaj



DREJTORI  
Paulin Gjergji



KRYETARI  
Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA BUJQËSISË UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE  
SEKTORI INSPEKTIMIT MBROJTJES PYJEVE E KULLOTAVE

MIRATOHET  
KRYETARI I BASHKISË  
Pjerin Ndreu



PLAN MASASH  
Nr 5302/2 datë 23.04 2026

PËR

PARANDALIMIN, MENAXHIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE  
NË PYJE E KULLOTA, SI DHE PËR NGRITJEN E NJËSIVE VULLNETARE  
TË SHUARJES SË ZJARR EVE PËR VITIN 2026

**Baza ligjore :**

Ligji nr 115/ 2014 “ Për ndarjen Administrative – Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë “ Ligjit nr139/ 2015 “ Për vetëqeverisjen vendore “  
Ligji nr .57 datë 30.04.2020 ‘ Për pyjet “  
Ligji nr .9693 , datë 19.03.2007 “ Për fondin Kollusor “ I ndryshuar  
Ligji nr .10431 , datë 09.06.2011 “ Për Mbrojtjen e Mjedisit “  
Ligji nr 45 datë 18.07.2019 “ Për mbrojtjen Civile ‘  
Ligji nr . 152 , datë 21.12.2015 “ Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi “  
VKM – ja. nr . 1080. datë 22.12.2010 ‘ Mbi rregullat për shuarjen e zjarreve në pyje e kullota

**Përkufizime :**

“ **Rrezik zjarri** “ është situata e krijuar nga akumulimi i faktoreve që nxisin mundësinë e nisjes së zjarrit dhe zhvillimit të tij .  
‘ **Sisteme të diktimit – sinjalizimit** “ janë pajisje që diktojnë, sinjalizojnë shfaqjen e tymit gazrave dhe zjarrit .  
“ **Shërbimi vullnetar i mbrojtjes nga zjarri** “ është organizimi i strukturës vullnetare për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi , nga organet e qeverisjes vendore , nga personat juridikë , që kryejnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë , nga institucione dhe agjensi shtetërore , të cilat kanë përgjegjësi për administrimin e pasurive shtetërore me rrezikshmëri nga zjarret  
“ **Zjarr** “ është dukuria e djegjes , e shoqëruar me nxehtësi të lartë tym dhe dritë në formë flakësh përcjellse.  
“ **Zjarr normal** “ është zjarri që shkakton dëm,për përballimin e të cilit janë të mjaftueshme forcat operacionale, mjetet dhe pajisjet e stacionit zjarrfikës të Bashkisë.

**‘Zjarr masiv’** është zjarri që zhvillohet apo tenton të zhvillohet në sipërfaqe e volume të konsiderueshme për përballimin e të cilit përveç forcave operacionale mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës i një stacioni, kërkohet edhe pjesmarrja për ndihmë nga stacionet zjarrfikëse të Bashkive të tjera.

**“Zjarr me përmasa të mëdha”** është zjarri që zhvillohet në sipërfaqe e volume të mëdha për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës, kërkohet edhe pjesëmarrja për ndihmë e forcave e mjeteve të shërbimeve apo strukturave të tjera operuese.

**“Organizim i ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimi”** është tërësia e masave teknike-organizative të nevojshme, për organizimin e forcave të ndryshme, mjeteve, pajisjeve zjarrfikëse, metodave e taktikave, të cilat përdoren për ndërhyrjen në shuarjen e zjarrit, evakuimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, kafshëve dhe pronës.

**“Mbrotjtja e pyjeve dhe e tokës pyjore”** është veprimtaria për parandalimin e degradimit, përtëritjes, ruajtjen dhe përmirsimin e pyjeve të burimeve pyjore e jo pyjore bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor nga faktorët njerëzor e natyrorë.

**“Pyll bashkiak”** është pylli në pronësi apo në përdorim të organeve të qeverisjes vendore.

**“Emergjence civile”** është situatë e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe cenon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgimin kulturore dhe mjedisin.

**“Fatkeqësi natyrore”** janë fatkeqësi që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme që lidhen me tërmetet, përmbytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tejjzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgimin kulturore dhe mjedisin.

**“Mbrotjtja Civile”** është tërësia e masave të marra për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gadishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësi të tjera, me qëllim mbrotjtjen e jetës së njerëzve, gjësë gjallë, pronën, trashëgimin kulturore dhe mjedisin.

Në rast se në fondin pyjor apo në një pjesë pylli, shkurre apo kullotë bie zjarr, organet e shërbimit pyjorë, organet e njësisë të qeverisjes vendore, cdo subjekt shtetëror apo privat, njësi apo rrepart ushtarak, shkollë, institucion publik dhe privat, si dhe cdo shtetas kanë për detyrë të lajmërojnë dhe të marrin pjesë në shuarjen e tij.

**Bashkia Lezhë me strukturat e saj, Njësitë Administrative, Drejtorinë e Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimin e Pyjeve, në zbatim të dispozitave ligjore si mësipër, për**

parandalimin dhe menaxhimin e shuarjes së zjarreve në fondin pyjor- kullor në administrimin e saj parashikon marrjen e masave organizative si më poshtë. Në rastet e zjarreve në pyje e kullota në territorin e Bashkisë Lezhë ngrihet dhe funksionon Shtabi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi i cili drejton dhe organizon gjithë veprimtarinë për:

“ Organizimin e Ndërhyrjes në Shuarjen e Zjarrit dhe Shpëtimit”.

Ky shtab kryesohet nga Kryetari i Bashkisë Z. Pjerin Ndreu dhe përbëhet nga :

**Z.Fatjon Zefi .**

Zv/Kryetar i Bashkisë Lezhë, “ Sekretar i Shtabit.”

**Z.Gjegj Prendi .**

Drejtor i Emergjencave Civile. MZSH.

**Z.Ferdinand Preçi.**

Drejtor i Drejtorisë MZSh

**Z.Leonard Palaj.**

K/Inspektor i Policisë Bashkiake.

**Z.Marta Fertaj.**

Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social.

**Z.Paulin Gjergji.**

Drejtor i Drejtorisë Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve.

**Z Rajmonda Prendaj .Administratore.**

Njesia Administrative Zejmen.

**Z.Xhovana Kodra .**

Administratore.

Njesia Administrative Kolsh.

**Z.Brahim Demi Administrator.**

Njesia Administrative Shëngjin.

**Z.Eridon Gjeloshi Administrator.**

Njësia Administrative Balldre.

**Z.Eraldo Marku Administrator.**

Njësia Administrative Kallmet.

**Z.Pjeter Gjini Administrator.**  
**Njësia Administrative Blinisht.**

**Z.Agustin Zefi Administrator**  
**Njësia Administrative Ungrej.**

**Pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, ngrihet Shtabi i Drejtorisë i cili ka të organizuar sistemin e vrojtimit- sinjalizimit me anë strukturës së Rojtarëve dhe Teknikëve, ( përsone përgjegjes të zonave pyjore }**

**Të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Lezhë të organizojnë “Shërbim vullnetar te mbrojtjes nga zjarri”.**

**Këto skuadra përbëhen nga 8-10 anëtarë dhe do të mbahen në efijencë të plotë nga Njësitë Administrative Njëpërmjet Rojtarëve dhe Teknikëve (përsone përgjegjes të zonave pyjore ) brenda territorit të Njësisë.**

**Skuadra e “Shërbimit vullnetarë të mbrojtjes nga zjarri” do të jenë strukturat e para së bashku me strukturat e tjera pyjore do të mbajnë nën kontroll zjarrin deri në mbërritjen e forcave dhe mjeteve që do të organizohen nga Shtabi i Bashkisë Lezhë.**

**Afati i realizimit : Prill 2026.**

**Struktura e Njësisë Vullnetare për shuarje Zjarri Rojtarë dhe Teknik ( përsone përgjegjës për zonat pyjore), njëpërmjet Drejtorisë Emergjencave Civile, Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, do të trajnohen dhe kualifikohen për mënyren e shuarjes së zjarrit në pyje dhe kullota.**

**Afati deri me 15 Maj 2026.**

**-----Bashkia Lezhë nëpërmjet strukturave të saj të Drejtorisë së Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit Pyjeve, Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe MZSH, shoqatave të ndryshme të pyjeve e të tjerë do të organizojë takime dhe biseda sensibilizimi me kumonitetin e zonave pyjore, nxënësit e shkollave në këto zona për rëndësin e mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave.**

**Afati i realizimit gjatë gjithë vitit 2026.**

**-----Harta e Zonave të Rrezikuara nga Zjarri për Pyjet e Kullotat e cila përmban të gjitha objektet e ekspozuara nga zjarret, largësitë e tyre nga qendrat e banuara, pikat e vrojtimit sinjalizimit, rrugët për lëvizjen e mjeteve në territorin e Bashkisë Lezhë, do bëhet publike në të gjitha Njësitë Administrative të cilat kanë zonë pyjore të rrezikuara, shkolla si dhe ambiente të tjera publike.**

Kjo hartë do ti vihet në dispozicion edhe Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe MZSH.

**Afati muaj Maj 2026.**

-----Punonjësit e Sektorit të Inspektimit Mbrojtjes Pyjeve e Kullotave dhe si punonjësit e Sektorit të Administrimit të Pyjeve pranë Drejtorisë së Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit Pyjeve. Rojtarët dhe Teknikët pyjore (përsona përgjegjës për zonat pyjore) detyrohen të mbajnë takime me Administratorët e Njësive Administrative, me komunitetin e zonës, barinjtë në kullota, subjekte të tjera që veprojnë në mjedisin pyjor e kulloror me qëllim ndërgjegjësimin për rëndësinë e pyjeve dhe kullotave si dhe parandalimin e rënies së zjarreve.

**Afati i realizimit: gjate gjithë vitit.2026**

-----Sektori i Inspektimit Mbrojtjes Pyjeve e Kullotave gjatë periudhës së emergjencës (Maj -Tetor) do të ketë në cdo moment lëvizjen e punonjësve. Për çdo lëvizje të lihet numri i telefonit.

**Afati i realizimit Maj-Tetor.**

-----Rojtarët dhe teknikët pyjor (përsona përgjegjës për zonat pyjore) gjatë periudhës së emergjencës do të njoftojnë pranë Sektorit të Inspektimit Mbrojtjes Pyjeve Kullotave 4 (katër) herë në ditë përkatësishtë.

Në orën 08:00, 11:00, 15:00, 18:00 mbi situatën në zonën pyjore që mbulojnë.

Për informacionet që do jepen nga Rojtarët dhe Teknikë pyjorë do mbahen në Librin e Gadishmërisë që do ndiqet nga një punonjës i Sektorit të Inspektimit. (mosnjoftimi në kohë reale ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës).

-----Informacioni është i detyrueshëm gjatë gjithë vitit por në veçanti gjatë periudhës së Emergjencës nga muaji (Maj-Tetor).

-----Sektori i Inspektimit Mbrojtjes Pyjeve e Kullotave pranë Drejtorisë së Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit Pyjeve gjatë periudhës së emergjencës (Maj-Tetor), çdo të Hënë dorëzon pranë Bashkisë Lezhë evidencën operative të situatës javore për zjarret.

-----Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonë pyjore kullorore Rojtari dhe Tekniku i pyjeve kryen veprimet si më poshtë:

**1-Njofton menjëherë në numrin e telefonit 128 Shërbimin Zjarrfikës dhe 129 të Policisë së Shtetit .**

Ku prezanton veten me emer mbiemër dhe tregon vendodhjen e saktë si dhe vendin e vatrës së zjarrit duke dhënë pika orientuese të sakta dhe vendin e vatrës së zjarrit dhe përcaktimin e zonës pyjore ku ka rënë zjarri ( në pyje , kullota apo shkurre) .

**2-Njofton Përgjegjësën e Sektorit Inspektimit dhe Mbrojtjes Pyjeve e Kullotave**  
-----Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonë pyjore kullosore dhe marrjen e njoftimit nga Rojtari apo Tekniku i Pyjeve, Administratori i Njesisë Administrative kryen veprime si më poshtë:

1-Njofton Kryetarin e Bashkisë në pozicionin e Kryetarit të Shtabit ose njofton për situatën në grupin e Ëhatsapp.

2-Njofton Struktura e Njesisë Vullnetare për Shuarjen e Zjarrit e cila është ngritur dhe funksionon pranë Njesisë Administrimit në fjalë.

3-Të gjithë bashkë organizohen për shuarjen e zjarrit ose lokalizimin e tij deri në mbërritjen e forcave të specializuara për mbrojtjen nga zjarri.

**Shtabi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi mbledhen në cdo kohë që shihet nga kryetari i saj.**

**Në këto mbledhje do të analizojë gjëndjen dhe do të përcaktojë masat që do merren në vazhdimësi në përputhje me që mund të krijohen .**

Pregatit dhe përpilon komunikatën dhe informacione të tjera të nevojshme në funksion të situatës për punën e bërë në Mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave nga zjarret.

-----Shtabi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi në rastet e “ Zjarreve Masive “ apo “ Zjarreve me përmasave të mëdha “ sipas situatës që krijohet , i këkon Institucionit të Prefektit në pozicionin e Kryetarit të Shtabit Qëndror ndihmë për përballimin e situatës .

-----Të gjitha Strukturat e Bashkisë të cilat janë pjesë e planit të masave , duhet të pregatisin programin e detajuar për marrjen e masave për mbrojtjen e pyjeve e kullotave nga zjarri .

**Afati i realizimit : Maj 2026.**

-----**Bashkangjitur planit të masave , kemi tabelën me të dhënat e Rojtarëve e Teknikëve që kanë në ruajtje pyje dhe kullota sipas Njësive Administrative , dhe Ekonomive Pyjore , Skema e organizimit dhe Harta e Ekonomive Pyjore në të cilën pasqyrohen zonat me rrezikshmëri të lartë zjarri që përbëhen nga Formacionet e Pyjeve të Halorëve ( pishë e zezë, pishë e egër, pishë e butë etj ) .**

Hartoi :  
Përgjegjësi i Sektorit  
Viktor Ujkaj



**DREJTORI**  
**Paulin Gjergji**



**LISTA EMRORE E ROJTARËVE DHE TEKNIKËVE ,DHE ZONAT  
ME SIP / HA QË KANË NË RUAJTJE  
SI DHE NUMRAT E KONTAKTIT**



VITI 2026

| EMRI<br>MBIEMRI      | EKONOMIA<br>PYJORE | SIP<br>në / Ha | Fshatrat në zonën Pyjore  | Nr celularit |
|----------------------|--------------------|----------------|---|--------------|
| Bardhok<br>Kovaci    | MALUNG             | 1714.07        | Prull,Tresh,Spiten,M-Tomaj,<br>Zejmen ,<br>Plllanë. Njësia Adm ZEJMEN | 0692540935   |
| Endrit<br>Kthella    | MALUNG             | 842.94         | Grykë/Manati,Manat, Manati<br>Vjetër..<br>NjAdm KOLSH                 | 0694694955   |
| Mark Lesaj           | MALUNG             | 1149.44        | Kaçinar,Lalm,Patalej,Gjash,Velë.<br>Nj.Administrative KOLSH           | 0682360966   |
| Pal Gjetaj           | MALUNG             | 661.17         | Kolsh , Grykë Manati<br>Nj. Ad KOLSH                                  | 0682535630   |
| Mirsad<br>Lushaj     | ZADRIMË            | 1549.90        | Merqi, Rrobo, Kall, K/Vogël.<br>Nj/Ad Kallmet                         | 0699119427   |
| Klevantina<br>Lleshi | ZADRIMË            | 1607.57        | Troshan , Fishtë, Krajen , Kodhel ,<br>Nj/ Administrative BLINISHT    | 0672568646   |
| Vakant               | M. KAKARRIQ        | 791.56         | Kakarriq , Nj/ Ad .<br>BALLDRE  |              |
| Fatjon Gjini         | M.KAKARRIQ         | 1201.04        | Balldre , Torovicë, Shkami i Kuq<br>Nj/ Administrative . BALLDRE      | 0682045444   |
| VAKANT               | B .TERTONIT        | 2651.00        | Kalur , Ungrej , Sukaxhi .<br>Nj/ Administrative UNGREJ               | Vakant       |
| Pjetër<br>Gjonocaj   | B. TERTONIT        | 2602.62        | Ungrej ,Fregen . ½ Kalur<br>Nj/ Administrative UNGREJ                 | 0693622206   |
| Pëllumb<br>Ndreca    | B. KRESHTËS        | 2215.80        | Zimaj, Kalivaç, Rras ,Fregen .Nj/<br>Ad<br>UNGREJ                     | 0682129286   |
| Gjon Brokshi         | N. KRESHTËS        | 2402.34        | Kashnjet,Sukaxhi,Kalivaç,Gjobar<br>dhaj.<br>Q. Pazarit. Nj/ UNGREJ    | 0684715669   |
| Prel Malaj           | M. RRENXIT         | 1393.04        | Komplet Malin e Shëngjinit<br>Nj/ Ad. SHËNGJIN                        | 0673977077   |

Përgjegjësi  
Viktor Ujkaj



Skema e organizimit, detyrat kryesore të strukturave për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota



# HARTA E PYJEVE DHE KULLOTAVE BASHKIA LEZHE


NDARE SIPAS PRONESISE

SH : 1 : 50.000













BASHKIA SHKODER

BASHKIA VAU DEJES

BASHKIA PUKU



## SHPJEGUES

-  PYJE Bashkia
-  PYJE PRIVAT
-  KULLOTA
-  KULLOTA
-  ZONA E MBROJTUR
-  ZONE BUFERIKE
-  RRUGE AUTO
-  SIPERFAQE INPRODUKTIVE
-  MONUMENTE NATYRE
-  FABRIKE CIMENTOJE
-  EKONOMI BUJQESORE
-  KUPI EKONOMIE

### EKONOMI PYJORE SHENUAR ME NR

1. SHENONJE - DATE
2. MOLLERJE
3. ZARRRDE
4. DRIDHAT E BRESHTES
5. DRIDHAT E TERTORIT
6. PUNA POKRONT
7. TRESI KASHTRORE

BASHKIA KURBIN

**PARCELAT E KONTURUARA ME VIJE TE VERDHE JANE ZONA ME RREZIKSHMERI TE LARTE ZJRRI PASI JANE TE PERBERA NGA PYJE HALORE .**